

GYKATA KOMUNALE E PRIZRENT
P. nr. 917/10
7 Tetor 2010

NE EMER TE POPULLIT

GYKATA KOMUNALE E PRIZRENT

Ne kolegjin e perber nga tre gjyqtaret;

Gjyqtar ndërkombëtar i EULEX-it Witold Jakimko si Kryetari i trupit gjykses,
Gjyqtar ndërkombëtar i EULEX-it Jonathan Welford - Carroll dhe gjyqtar vendor
nga Kosova **Emrush Kasrati**

Ne asistencë te **Christin Nilsson, Robert Abercrombie dhe Robina Struthers**
si procesmbajtëse dhe Ilir Ejupi, Leke Nimani dhe Altina Ruli si përkthyes

Ne rastin penal kunder:

Ekreem Agushi, i biri i Salit dhe Xhemiles (i vajzërisë Bytyqi) i lindur me
25 Janar 1958 in fshatin Gadime e Eperme, komuna Lipjanit, me banim te
tanishëm ne Gadime te Eperme, Shqiptar Kosovar, avokat i cili punon ne dy
kompani, i martuar, babai i katër fëmijëve, gjendje te mesme ekonomike,
numri i kartelës identifikuese 1011062993.

I akuzuar konform aktakuzës PP. nr. 524/09 te parashtruar nga prokurori komunal
ne Prizren me datën 3 Gusht 2009 me veprën penale te nxjerjes se kundërligjshme te
vendimeve gjyqësore ne kundërshtim me nenin 346 te Kodit Penal te Kosoves (ne
vazhdim si KPK- ja).

E përshtkruar si me poshtë:

Me 4 Qershor 2008 i pandehuri duke vepruar ne cilesin e gjyqtarit te gjykatës se
Qarkut te Prishtinës, ka tentuar qe ne mënyre te kundërligjshme te përfitoj dobi
pasurore për personin tjetër duke shkaktuar dëme personit tjetër nxjerr vendime te
kundërligjshme, respektivisht aktvendimin 547/2008 te dates 4 Qershor 2008.
Pas pranimit te dokumenteve te rastit mbi trashëgimin nëpërmjet një ankese, i
pandehuri nxjerr vendim te kundërligjshëm ku ai ka vendosur ne ankese ne baze te
aktvendimit te plotfuqishëm me pretendim te lëshuar nga gjykata komunale e

Prishinës T. Nr. 136/2002 te dates 14 Tetor 2002; supozohet qe Aktvendimi është lëshuar nga gjyqtari Zlatije Stanisic i cili nuk është selektuar konform dispozitave te UNMIK-ut nga Përfaqëuesi Special i Kombeve te Bashkuara. Aktvendimi është vërtetuar me një vule te rrumbullaket ku është shkruar një mbishkrim *Republika e Serbisë, Krahina Autonome e Kosoves dhe Metohisë, gjykata komunale e Prishtinës, gjykata paralele.*

Me mbajtjen e seancave me 6 dhe 7 Tetor 2010, ne prani te të pandehurit Ekrem Agushi, avokatit te tij mbrojtës Hamit Gashi , Prokurorit Publik Komunal te Prizrenit, Ariana Shajkovci,

konform nenit 390 te Kodit te Procedurës Penale te Kosoves (ne vazhdim si KPPK-ja) lëshon si ne vijim:

AKTGJYKIM

1. I pandehuri Ekrem Agushi, shënimet personale te të cilit janë cekur me larte, është shpallur **I PAFAJSHËM** për veprën penale te përshkruar me larte.
2. Konform nenit 99 dhe 103 paragrafi 1 i KPPK-se shpenzimet e procedurës penale duhet te paguhen nga resurset buxhetore te Kosoves.

ARSYETIM

1. Histori procedurale

Me 10 Nëntor 2008, aktvendimi mbi iniciimin e hetimeve PP. nr. 5105-15/2008 është lëshuar nga prokurori Publik Komunal i Prizrenit kunder Bashkim Latifit dhe Sulejman Nuredinit për dyshim te arsyeshëm se ata kane kryer veprën penale te nxjerjes se vendime te kundërligjshme ne kundërshtim me nenin 346 te KPPK-se. Ne ditën vijuese prokurori publik komunal ka iniciuar hetimet kunder Ekrem Agushit për te njëjtën dyshim (PP. nr. 5105-15/2008).

Prokurori Publik ka nxjerrur aktvendimin mbi ndërprejen e hetimeve kunder bashkim Latifit dhe Sulejman Nuredinit me 22 Janar 2009.

Me 3 Gusht 2009 prokurori publik komunal ne Prizren ka parashtruar aktakuzën PP. nr. 524/09 te dates 30 Korrik 2009 kunder Ekrem Agushit, i akuzuar për veprën penale te nxjerjes se vendimeve te kundërligjshme. Prokurori nuk e ka cekur palën e dëmtuar ne rast. Akruza kunder te pandehurit nuk pëmbante ndonjë informate lidhur me personat e dëmtuar.

Seanca dëgjimore është mbajtur nga gjyqtari Kosovar me 15 Shtator 2009. Seanca është shtyre ne baze te propozimit te avokatit mbrojtës.

Me 24 tetor 2009 avokati mbrojtës e ka njoftuar prokurorin publik rreth qëllimit te tij qe te prezantoj bazat për përjashtim te përgjegjësisë penale te të pandehurit, konform nenit 308 (1) alineja 2 te KPPK-se. Avokati mbrojtës me tutje ka kërkuar qe gjyqtari te kthej aktakuzën për modifikim tek prokurori publik mbasi qe nuk është përpiluar konform nenit 305 te KPPK-se.

Ne te njëjtën dite avokati mbrojtës ka parashtruar kërkesën për përjashtim te prokurorit publik te Kosoves i cili është caktuar ne këtë rast dhe ka kërkuar qe gjyqtaret dhe prokuroret e EULEX-it ta marrin përsipër rastin.

Me 28 Tetor 2009, edhe një seance konfirmimi është mbajtur ne gjykatën komunale te Prizrenit. Avokati mbrojtës ka bere peticion prokurorit publik qe te shqyrtoj aktakuzën. Ai ne vazhdim ka cekur se kërkesën e ka dorëzuar te gjyqtaret e EULEX-it. Gjyqtari i konfirmimit e ka aprovuar parashtrresën e avokatit mbrojtës dhe e ka shtyre seancën për një date te pa caktuar.

Rasti është caktuar tek gjyqtaret e EULEX –it mbas seancës te mbajtur ne gjykatën komunale te Prizrenit me 21 Janar 2010.

Me 26 Shkurt 201, seanca e konfirmimit e organizuar nga gjyqtaret e EULEX-it është shtyre për shkak te mungesës se prokurorit publik komunal.

Seanca tjetër e konfirmimit është mbajtur ne gjykatën komunale te Prizrenit me 2 Mars 2010. Gjyqtari i konfirmimit te EULEX – it me aktvendim KA. Nr. 116/09 e hedh poshtë aktakuzën PP. nr. 524/09, konform nenit 316 (1) alineja 4 te KPPK-se.

Prokurori ka pranuar qe nuk e ka cekur palën e dëmtuar ne aktakuze. Me tepër ne mënyre eksplicite ka deklaruar se demt iu është shkaktuar Republikës se Kosoves. Kunder aktvendimit te anuluar prokurori publik komunal parashtron ankesën me 10 Mars 2010. Me 15 Prill 2010 një kolegi i perber nga shumica e gjyqtarëve te EULEX-it e aprovoi ankesën dhe e konfirmoi aktakuzën (aktvendimin KP. Nr. 26/10).

Me 1 Korrik 2010 Gjykata Supreme e Kosoves me aktvendimin e saj PKL-KZZZ 47/10 e anulon si te pa lejueshëm kërkesën për mbrojtjen e ligshmerisë te parashtruar nga avokati mbrojtës kunder aktvendimit konfirmues te dates 15 Prill 2010.

2. Shqyrtim i kryesor

a) Procedure e provave

Seanca paraprake është mbajtur për rastin me numër nr 917/10 me 6 Tetor 2010. Shqyrtimi kryesor ka filluar në të njëjtën ditë dhe vazhdoi me 7 Tetor 2010.

Gjate seancave gjyqësore Sulejman Nuredini dhe Bashkim Latifi kane dëshmuar me 6 Tetor 2010. I pandehuri është dëgjuar nga kolegji në ditën vijuese

Kolegji penal ka pranuar si prove dokumentet¹ vijuese:

1. Prova A1, procesverbali i marrjes në pyetje të Bashkim Latift të dates 26 Shtator 2008 (dy përkrhmet)
2. Prova A2, procesverbali i marrjes në pyetje të Sulejman Nuredinit, të dates 6 Nentor 2008.
3. Prova A3, procesverbali i marrjes në pyetje të Sulejman Nuredinit, të dates 26 Nentor 2008
4. Prova B1, aktvendimi i gjykatës komunale të Prishtinës (dega në Graçanicë) nr. 136/2002, të dates 14 Tetor 2002.
5. Prova B2, aktvendimi i gjykatës komunale të Prishtinës T. nr. 24/08 të dates 31 Mars 2008 lidhur me vërtetimin e krijimit të trashëgimisë.
6. Prova B3, aktvendimi i gjykatës së garkut të Prishtinës, Ac. nr. 547/2008 të dates 4 Qershor 2008.
7. Prova B4, aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosoves, MLC, nr. 12/2008 të dates 11 Shtator 2009, mbi kërkesën rreth mbrojtjes së ligjshmërisë.
8. Prova B5, aktvendimi i gjykatës së garkut të Prishtinës, Ac. nr. 1103/2009 të dates 8 Qershor 2009
9. Prova C1, versioni original i aktvendimit të gjykatë komunal ete Prishtinës (dega në Graçanicë), O. nr. 136/2002 të dates 14 Tetor 2002.

Duke vrejtur që palet nuk kane kundërshtime, procesverbalet e dëshmitarëve, të dëgjuar me 26 Shtator 2008, 6 Nentor 2008 dhe 26 Shtator 2008 janë konsideruar si të lexuara konform nenit 364 të KPPK-se, *a contrario*. Palet nuk kane parashtruar ndonjë kundërshtim që të konsiderohen provat të tjera sikurse që janë lexuar.

Gjate seancës paraprake, avokati mbrojtës ka dorëzuar parashtrësën që të pranohet si dëshmi², aktvendimin e gjykatës komunale të Prishtinës, T. nr. 645/09 të dates 5 Janar 2010 (lidhur me ndërprejten e procedurës së trashëgimisë); po ashtu edhe

¹ Procesverbal të shqyrtimit kryesor, rasti P. nr. 917/10, me 7 Tetor 2010, faqet 1 dhe ; faqe 11

² Procesverbal i seancës paraprake, rasti P. nr. 917/10, me 6 Tetor 2010, faqe 2-3

kallëzime penale te parashtruar nga zyra e prokurorisë publike ne Prishtine BpN 142-10-10 te dates 14 Maj 2010, e dorëzuar nga Policia. Kallëzimi penal përfshin dy persona te quajtur Musli Xhemali dhe Jovica Miliwojevic, te cilat kane tentuar te manipulojnë gjykatën lidhur me procedurën kontestuese te trashëgimisë. Avokati mbrojtës dhe Ekrem Agushi po ashtu e kanë cëkur kërkesën për mbrojtjen e ligshmërisë te parashtruar nga Prokurori Publik i Kosoves ne baze te kërkesës se trashëguesit Novica Miliwojevic.

Kryetari i trupit gjykues ka kërkuar nga avokati mbrojtës te siguroje kopjet e këtyre dokumenteve për gjykatën dhe prokurorin publike.

Gjate shqyrtimit kryesor avokati mbrojtës ka përsëritur parashtrësën³ e tij.

Prokurori publik nuk ia ka kundërshtuar avokatit mbrojtës propozimin, mirëpo ka kërkuar qe te njihet me kallëzimin penal. Kryetari i trupit gjykues pjesërisht e ka aprovuar parashtrësën dhe e ka regjistruar aktvendimin e gjykatës Supreme te Kosoves NLC 12/2008 si prove B4 dhe aktvendimin e gjykatës se garkut te Prishtinës Ac. nr. 1103/2009 si prove B5, ne procesverbal⁴ te shqyrtimit. Kolegji i ka mohuar parashtrësa te tjera si te pa rëndësishme për qeshitjen kryesore te shqyrtimit konform nenit 154 (1) i KPPK⁵-se.

b) Fjalimi përfundimtar i prokurorit publik komunal te Prizrenit⁶

Prokurori publik qëndron pranë aktakuzës PP. nr. 524/09 te parashtruar me 3 Gusht 2009. Prokurori deklaroi se nuk është kontestuese lidhur me ndricimin e provave te administruara gjate gjykimit se Aktvendimi Ac. nr. 457/2008 është nxjerrtur me 4 Qershor 2008, ku propozimi i Miliwojevic është refuzuar si i paparranueshëm. Aktvendim T. nr. 136/2002 i dates 14 Tetor 2002 i leshura nga gjykata paralele nuk është legjitim.

Prokurori publik mbështet se te gjitha elementet te veprës penale nen nenin 346 te KPK-se janë plotësuar ne këtë rast. Prandaj ajo propozon qe gjykata te shpall te pandehurin fajtorë dhe te dënohet ne përputhje me rrethanat.

³ Procesverbal i shqyrtimit kryeso, rasti P. nr. 917/10, me 7 Tetor 2010, fage 2

⁴ Ibid

⁵ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, rasti P. nr. 917/10 me 7 Tetor 2010 fage 2-3

⁶ Ibid, fage 13-14

c) Fjalim i përfundimtar i avokatit mbrojtës dhe i te pandehurit?

Avokati mbrojtës pohon se nuk ka provë lidhur me te gjitha elementet e veprës penale nen nenin 346 te KPP-se. Ai ceku qe kërkesa për rastin duhet te merret përsipër nga gjyqtar te EULEX-it dhe intervenimi i zyrës se prokurorise ne këtë rast. Ai referohet mungesës se saktësisë se aktakuzës dhe anulimit te saj mbas seancës se konfirmimit.

Avokati mbrojtës konsideron se qëllimi specifik i te pandehurit për te përfutur ne mënyre te kundërligjshme, për vete apo për te tjerët, apo te shkaktoj dem tek pala e trete nen nenin 346 te KPP-se nuk është e cekur ne aktakuzë. Ne baze te mendimit te Hamit Gashit ligji parashih se benificioni i pare duhet te jete për te pandehurin; nëse dobia materiale është për personin tjetër, qeshitja e kryerjes se veprës penale është e gërshtuar me aktin vetvetiu. Ai pretendon edhe nëse e drejta e palës ne procedure civile është shkelur. është rregulluar ne nivel te instancës se dyte. Lënda është dërguar për rigjykim ne gjykatën komunale te Prishtinës, dhe procedura e trashëgimisë është ne vazhdim.

Ai thekson se kryerja e veprës penale nuk është provuar. Qellim i specifik i te akuzuarit nuk është konfirmuar. Ai ne vazhdim propozon gjykatës qe te liroj te pandehurin.

Ekrem Agushi referohet procedurës ne vazhdim ne kontest civil. Ai e cek aktvendimin e trashëgimisë i cili nuk është mundur te verifikohet ne regjistrin publik te pronës se paluajtshme, për shkak te kontestit te pronës.

Ai thekson se ai është i pafajshëm dhe se elementet kryesore te veprës penale nuk janë plotësuar. Prokurori publik dëshron te argumentoj qe ai ka përfutur apo ka siguruar profit nga nxjerja e vendimit fajësues apo ka mundësuar palës se trete përfitime nga akti i tij i veprimt. Ne fund ai thekson ndikimin e kësaj procedure penale ne profesionin e tij dhe ne jetën personale.

3. Gjetjet e gjykatës

a) Deklarata e dëshmitarit Sulejman Nuredini

Gjate seancës se mbajtur me 6 Tetor 201, Sulejman Nuredini ka dëshmuar para gjykatës.

⁷ Ibid, faqe 14-16

Sulejman Nuredini qëndroi plotësisht pranë deklaratës së me hershme të dhënuar pranë prokurorisë publike komunale. Ai referoi dispozitave të gjetura ndërmjet neneve 200 deri në 230 të Ligjit të procedurës Kontestimore (në vazhdim LPK-ja). Ai theksoi se lënda e trashëgimisë është caktuar pa ndonjë kundërshtim tek Ekrem Agushi i cili po ashtu ishte edhe kryetari i trupit gjyqës.

Dëshmitari ka sqaruar se gjyqtari raportues është përgjegjës për saktësin, vërtetësin dhe ligjshmërinë në baze të ligjit dhe në baze të besimit⁸ profesional. I pandehuri si gjyqtar raportues ka bërë vlerësimin e rasti dhe e ka prezantuar rastin kolegjiv gjatë seancës⁹.

Sulejman Nuredini ka deklaruar se në kontestin civil, Ekrem Agushi “ka deklaruar se aktvendimi i instancës së parë përmban shkelje serioze”¹⁰ dhe është vendosur rreth rasti. Dëshmitari ishte i bindur se të dy aktvendime të gjykarës komunale të Prishtinës ishin nga gjykatat legale¹¹. Gjykatara ka vendosur në këtë qeshitje dy here (*res judicata*) dhe se aktvendimi i fundit normalisht prishet dhe ai i dates se me hershme mbetet.¹² Ishte rasti i një shkelje thelbësore të natarës absolute dhe se aktvendimi është dashur që të prishet¹³.

Në baze të dëshmisë së tij, Ekrem Agushi nuk ka raportuar se aktvendimi është nxjerrur nga gjykatara paralele. Aktvendimi nuk është prezantuar anëtarëve të tjerë të kolegjiv të as ndonjë prove tjetër. Me vone kur procedura penale është iniciuar i pandehuri do të kishte treguar se ka dështuar të shoh se aktvendimi ishte i një gjykatë paralele¹⁴.

Në baze të dëshmisë së tij, deklaratat e përgjegjësive të gjyqtarit raportues për saktësi dhe ligjshmëri të vendimit është nënshkruar nga anëtarët e kolegjiv mbas ndodhjes së incidentit. Është përpiluar në pikë vështrim të rasteve të shumta në priftje dhe në baze të besimit të përbashkët dhe dispozitave ligjore¹⁵. Ai theksoi se mbas kësaj janë krijuar kolegje të veçanta dhe anëtarët plotësisht kanë ndryshuar metodën e tyre të punës.

Sulejman Nuredini deklaroi se ai asnjëherë nuk ka vrejtur ndonjë parregullsi e as që ka pasur ndonjë dyshim¹⁶ dhe se ai nuk i njeh palët në kontest civil mbasi që ai

⁸ Proceasverbali i shqyrtimit kryesor, lënda P. nr. 917/10 me 6 Tetor 2010, faqe 5

⁹ Ibid, faqe 3

¹⁰ Ibid, faqe 4

¹¹ Ibid, faqe 10

¹² Ibid, faqe 6

¹³ Ibid, faqe 6

¹⁴ Ibid, faqe 4

¹⁵ Ibid, faqe 5

¹⁶ Ibid, faqe 7-8

brenda vitit ka vendosur për 400 raste.¹⁷ Dëshmitari ka cekur mundësin rreth kërkimin të ndihmës për një këshill ligjore të jashtëzakonshme dhe rezultati i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë i parashtruar pranë gjykatës Supreme të Kosovës (hudhje poshtë e aktvendimit të gjykatës së qarkut)¹⁸.

b) Deklarata e dëshmitarit Bashkim Latifi

Dëshmitari Bashkim Latifi ka dëshmuar me 6 Tetor 2010 pranë gjykatës; Ne vitin 2007 ai është caktuar ne gjykatën e qarkut të Prishtinës si gjyqtar civil ne nivel te gjykatës se apelit, për shkak te numrit te madhe te kontesteve qe duhet te zgjidhen¹⁹.

Ai ka cekur se "gjyqtari raportues ishte i obligueshem qe te analizoje dokumentet e rasis dhe te referoj rasin ne menyre profesionale duke i analizuar te gjitha dokumentet dhe duke dërguar propozimin"²⁰. Kishite besim ne profesionalizmin e njeri- tjetrit. Veprimi ndërmjet anëtarëve te kolegjit ishte korrekt²¹.

Dëshmitarit i kujtohet se ne kontestin civil, mbasi është referuar si *res judicata* dhe ishte një shkelje thelbësore, anëtarët e kolegjit nuk kishin dilema dhe i nënskruan procesverbalin e pleqinimit²². Aktvendimi nuk iu është prezantuar anëtarëve te tjerë te kolegjit²³. Ai nuk e ka ditur qe rasti është gjykuar nga një gjykate ilegale. Ai me vone ka dërguar për këtë shkelje²⁴.

Dëshmitari Bashkim Latifi deklaroi se ata kishin një numër te madhe te rasteve ne atë kohe. Ai asnjëherë nuk ka dyshuar se një parregullsi ka ndodhur ne këtë rast apo ne ndonjë rast tjetër dhe se asnjëherë nuk kishin problem me herët²⁵.

Dëshmitari ka deklaruar se ai nuk i njih palet ne kontestin civil dhe se asnjëherë nuk ishte ne kontakt me ta²⁶.

Bashkim Latifi ka cekur deklarata e cila ishte nënskruar nga anëtarët e kolegjit me te cilat ka punuar mbas nxjerrjes se këtij vendimi fajësues sepse ishte e pamundshme qe te analizohen te gjitha dokumentet kur kolegu ka vepruar si gjyqtar raportues.

¹⁷ Ibid, faqe 10

¹⁸ Ibid, faqe10-11

¹⁹ Ibid, faqe 11

²⁰ Ibid, faqe 11

²¹ Ibid, faqe 17

²² Ibid, faqe11

²³ Ibid, faqe11

²⁴ Ibid, faqe 11 dhe 12

²⁵ Ibid, faqe12-13

²⁶ Ibid, faqe 13

Është bere një praktik e përgjithshme ne te ardhmen. Mbas këtij rasti civil ai nuk deshi qe te gjykoje rastet me Ekrem Agushin, ashtu qe kolegjti tjetër është formuar²⁷.

c) Deklarata e te pandehurit

I pandehuri Ekrem Agushi është marrur ne pyetje nga gjykata me 7 Tetor 2010.

Ekrem Agushi ka deklaruar se ne rastin e trashëgimisë ne fjale, si kryetar i trupit gjykuesi ai iu ka bere ftesat kolegeve te tij, Sulejman Nuredini dhe Bashkim Latifti qe te votojnë dhe pleqnojnë ne zyrën e tij. Ai ishte i obliguar qe te krijoj kushte pe kolegjti qe te vendosin dhe te votojnë lidhur me rastet te cilat janë përgatitur për gjykim (ndoshta 10 raste).

Kur është hapur seanca ne këtë rast, Sulejman Nuredini e ka pyetur qe te raportoj rastin ne një mënyre me akademike për shkak te mungesës se njohurisë se dy anëtarëve tjerë te kolegjti, po ashtu për shkak te mos përvojës se tyre ne gjykimin e rasteve trashëguese. Anëtarët e kolegjti kane kërkuar qe diskutimi te referohet dokumenteve faqe për faqe²⁸.

I pandehuri ka deklaruar se si gjyqtar raportues ai konsideron ankesën si te kompletuar. Ai ishte duke mbajtur aktvendimin O. nr. 136/02 te dates 14 tetor 2002 ne dorën e tij mbasi kolegjet e tij kishin djeneri tresh gjuhës Serbe me mire se ai, ai ia dha fjalën tyre²⁹.

Ekrem Agushi deklaroi se kolegjti i apelit ishte duke u marrur me vendimin nga një gjykate institucionale, dega ne Graçanice³⁰. Ekrem Agushi deklaroi se ai e lexoi aktvendimin³¹. Ekrem Agushi deklaroi se mbishkrimi Republika e Serbisë ne vule e ven përmbi Aktvendim ishte e pamundshme te lexohet. Ishte kopja e aktvendimit e cila nuk është vërtetuar, nuk ishte origjinali. Vula ishte e dates Mars 2004, kurse vendimi është nxjerrur me 14 Tetor 2002. Ligjshmëria e dokumentit lidhur me këtë vule është vlerësuar ne pajtim me nenin 230 te LPK—se.

Palet ne kontest civil mund te kishin kërkuar origjinalin e aktvendimit , mirëpo ata kane dështuar te bëjnë një gjë te tille, mbasi qe nuk kane dështuar ne përmbajtje dhe ne vlefshmërinë e dokumentit. Sidoqoftë gjykata Supreme e Kosoves ka udhëzuar qe te kërkohet versioni origjinal³².

²⁷ Ibid, faqe 13-14

²⁸ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, rasti P. nr. 917/10, me 7 Tetor 2010, faqe 4

²⁹ Ibid, faqe 5

³⁰ Ibid, faqe 5

³¹ Ibid, faqe 8

³² Ibid, faqe9-10

Ai besoi se vula vinte nga gjykata e rregullt. Prova është vlerësuar ne pajtim me nenin 8 dhe 230 te LPK-se. Anëtarët e kolegjit ne mënyrë unanime kane vendosur se vendimi TNR 24/2008 i dates 31 Mars 2008 i gjykate komunale te Prishtinës, ishte pasoj e shkeljeve thelbësore sipas nenit 354 (2) alineja 12 te LPK-se. Ne fakt gjykata komunale e degës së Graganicës e nxori vendimin final në këtë rast te trashëgimisë, prandaj rasti ishte *res iudicata*³³.

I pandehuri ka cekur procedurën pra komisionit disiplinor te KGJK-se a iniciuar kundër tij. Seanca është mbajtur nga anëtarët e komisionit, Zivonj Gjoko Jokanovic, Harri Katara dhe Gabriele Walenich. Komisioni nuk ka gjetur ndonjë element qe te vendos për ndonjë mase disiplinore kundër Ekrem Agushit. I pandehuri ka vazhduar te punoje gjersa është eliminuar nga procedura e selektimit mbasi qe ai nuk është propozuar për ri cakim³⁴.

Ekrem Agushi ka cekur kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë nga prokurori publik mbas propozimit te Novica Mlivojevic kundër aktvendimit te gjykatës komunale te Prishtinës. Gjykata Supreme e Kosoves ka vendosur qe te kthej prapa rastin për ne instance te dyte për rigjykim. Kolegji i gjykatës se garkut te Prishtinës i perber nga i pandehuri si kryetar i trupit gjykues dhe si gjyqtar raportues Rahman Ratkoceri dhe Zahide Gjonaj e kane gjykuar rastin me 8 Tetor 2009. Kolegji e ka udhëzuar instancën e pare qe te veprojnë ne pajtim me vërejtje dhe udhëzime te Gjykatës Supreme te Kosoves³⁵.

Ne aktvendim MLC 12/2008re dates 11 Shtator 2009, gjykata komunale ka suspenduar procedurën trashëgimore dhe i ka udhëzuar palet qe te parashtrojnë kërkesë pronësore juridike. Procedura trashëgimore është ende ne proces³⁶.

I pandehuri ka deklaruar se ai nuk i njuh palet ne kontest civil, mirëpo i njuh ata vetëm me emër³⁷. Ekrem Agushi ka deklaruar se askush asnjëherë nuk ka intervenuar për te ndikuar ne procedurë³⁸. Ai asnjëherë nuk ishte ne lokalitet e degës se Graganicës. Ai nuk ka ditur qe ekziston edhe pse ai ka dëgjuar për gjykata paralele³⁹.

³³ Ibid, faqe5

³⁴ Ibid, faqe 6

³⁵ Ibid, faqe 8

³⁶ Ibid, faqe 8

³⁷ Ibid, faqe 11-12

³⁸ Ibid, faqe 12

³⁹ Ibid, faqe 11-12

d) Vlerësimi i dëshmiave

Kolegji prej tre gjyqtarëve të gjykatës së qarkut të Prishtinës, ka gjykuar rastin në baze të ankesës në një qeshitje trashëgimore, ata kanë nxjerrur aktvendimin Ac. nr. 547/2008 me 4 Qershor 2008⁴⁰.

Rasti civil ka të bëjë me trashëgiminë e Vojin Vitko Miliwojevic. Kolegji ka vendosur në baze të ankesës të parashtruar nga trashëguesi Jovica Miliwojevic kundër aktvendimit O. nr. 24/08 të datës 31 Mars 2008. Me këtë vendim O. nr. 24/08 gjykata komunale e Prishtinës ka shpallur trashëgimtar të të ndjerës (Stanimirka Miliwojevic, Novica Miliwojevic, Jovica Miliwojevic dhe Gorica Djimovic)⁴¹.

Kolegji i apelit ka vendosur të anuloi aktvendimin T. nr. 24/2008 mbasi që rasti ishte *res iudicata*, sepse është vendosur me herët sipas vendimit O. 136/2002 të datës 14 Tetor 2002 të nxjerrtur nga gjykata komunale e Prishtinës me seli në Graganice. Kolegji i gjykatës së qarkut ka gjetur se gjykata e shkalles së parë ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të nenit 354 (2) alineja 12 të LPK-se.

Me aktvendim O. nr. 136/2002 gjykata komunale në Prishtinë, lista e trashëguesve të Vojin Vitko Miliwojevic (Stanimirka Miliwojevic, Novica Miliwojevic, Jovica Miliwojevic) ishte shpallur dhe janë pajtuar me ndarjen e pronës. Është vërtetuar me vull të rrumbullakët me përkrahim *Republika e Serbisë, Krahina autonome e Kosoves dhe Metohisë, gjykata komunale e Prishtinës*⁴².

Nuk ka kontest ndërmjet palëve që gjykata me seli në Graganice ishte gjykata paralele e cila ka gjykuar në Kosove dhe se është themeluar në mënyrë ilegale. Gjyqtari i cili ka lëshuar vendimin Zllatija Stanisic, nuk është caktuar në pajtim me rregullore relevante të UNMIK-ut⁴³.

Kolegji i gjykatës së Qarkut të Prishtinës ishte i perber nga Ekrem Agushi në cilësi të kryetarit të trupit gjykues dhe gjyqtarit raportues (*juge rapporteur*), Sulejman Nuredini dhe Bashkim Latif ish-in si anëtar të kolegjit⁴⁴.

⁴⁰ Prova B3, Aktvendimi i gjykatës së qarkut të Prishtinës Ac. Nr. 547/2008 i datës 4 Qershor 2008

⁴¹ Prova B2, Aktvendimi gjykatës komunale të Prishtinës, nr. 24/08 të datës 31 Mars 2008 në përcaktim të bëries së trashëgimisë

⁴² Prova B1, Aktvendimi i gjykatës komunale të Prishtinës (dega në Graganice), O. nr. 136/2002 i datës 14 Tetor 2002; Prova C1, versioni origjinal i Aktvendimit të gjykatës komunale të Prishtinës (dega në Graganice) O. nr. 136/2002 i datës 14 Tetor 2002.

⁴³ Procesverbali i shqyrtimit kryesor, rasti P. nr. 91/7/10, me 6 Tetor 2010, faqet 10 dhe 15, faqe 16; Procesverbali i shqyrtimit kryesor, rasti P. nr. 91/7/10 me 7 Tetor 2010, faqet 5, 9 dhe 10

⁴⁴ Prova B3, Procesverbali i shqyrtimit kryesor, rasti P. nr. 91/7/10, dëshmia e Sulejman Nuredinit, 6 Tetor 2010, faqe 3-4, dëshmia e Bashkim Latifit, faqe 12, Procesverbali i shqyrtimit kryesor, rasti P. nr. 91/7/10, dëshmia e Sulejman Nuredinit, 7 Tetor 2010, deklarata e Ekrem Agushit, faqe 12.

Si gjyqtari raportues, i pandehuri ishte përgjegjës për vlerësimin dhe prezantimin e rastit. Ai si përgjegjësi shtese kishte për orar të seancave dhe prezantimin e raporteve të anëtarit të tjerë të kolegjit⁴⁵.

Dëshmitari Sulejman Nuredini rikujton raportin e rasti nga Ekrem Agushi “*ai deklaroi se aktvendimi i gjykatës se shkalles se pare ka përmbytur shkelje serioze*”. Në baze të dëshmisë së tij i pandehuri ka deklaruar se rasti është gjykuar me herët, se ekziston aktgjykimi i cili është sjedhur në këtë dhe se ekzistojë shkelje thelbësore të tij, dhe se ai ka marr pjesë në gjykim të tij. Anëtarët të tjerë të kolegjit nuk i kanë analizuar dokumentet në këtë rast dhe janë mbështetur në raportin të bere nga i pandehuri. Ekrem Agushi ceku se qeshja në ankese ishte *res judicata*; mirëpo i pandehuri nuk e ka cekur se vendimi është lëshuar nga gjykata paralele. Ekrem Agushi i kujtohet se ai është referuar në ekzistimin e vendimit të plotfuqishëm lidhur me trashëgiminë (aktvendimi O. nr. 136/2002).

I pandehuri ka dëgjuar rreth ekzistimit të gjykatave paralele. Ai deklaroi se ai e ka lexuar vendimin dhe se ka besuar se vendimi është lëshuar nga gjykata komunale e Prishtinës, si një gjykatë e themeluar në mënyre legale. Sulejman Nuredini dëshmoi se i pandehuri me vonë i ka treguar se ai ka dështuar që vërej se aktvendimi ishte i një gjykatë paralele.

Sipas deklaratës së Sulejman Nuredinit praktika ishte se “kur gjyqtari tregon se ekzistojë shkelje të aktgjykimit atëherë në qëndrojmë larg nga çdo koment rreth tij dhe thjeshtre në e prishim drejtpërsëdrejti një aktvendim të tillë.”⁴⁶

Gjykata me vëmendje e lexoi dëshmit në kuptim të nenit 346 të KPPK-se që parasheh si në vijim: “Gjyqtari apo gjyqtari laik, apo gjyqtari për kundërvajtje qellim i cili me qëllim të përfutimit të kundërligshëm të dobisë pasurore për vete ose për personin tjetër ose për t’i shkaktuar dëm personit tjetër nxjerr vendim të kundërligshëm dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet”.

Komentet e dispozitave mund të gjenden tek Kodi penal i Serbisë.⁴⁷ Referimi është bere për forma të tjera të veprave penale duke përfshirë keqpërdorimin e zyrës,

⁴⁵ Procesverbali i shqyrtimit kryesor, rasti P. nr. 91/7/10, 6 Tetor 2010, dëshmia e Sulejman Nuredinit, faqe 3-5; Procesverbali i shqyrtimit kryesor, rasti P. nr. 91/7/10, 6 Tetor 2010, dëshmia e Bashkim Latifit, faqe 11;

⁴⁶ Procesverbali i shqyrtimit kryesor, rasti P. nr. 91/7/10, 7 Tetor 2010, deklaratat e të pandehurit, faqe 4.

⁴⁷ Procesverbali i shqyrtimit kryesor, rasti P. nr. 91/7/10, 6 Tetor 2010, dëshmia e Sulejman Nuredinit, faqe 4

⁴⁸ Komentet e Kodit Penal të Serbisë, 1995, botimi i 5 “Savremena administracija”, Beograd, Srzentic Nikola – Ljubisa Lazarevic, nen nenin 243 të Kodit Penal të Serbisë (shkelja e ligjit nga gjyqtari) “Gjyqtari apo gjyqtari laik gjate procedurës së gjyqimit, i cili me qëllim tenton që të përfuttojë dobi materiale për personin tjetër apo të shkaktoj dëme të personit tjetër, e aprovon një akt ilegal apo në një mënyrë tjetër beas shkelje të ligjit, duhet të dënohet me burgim nga 6 muaj deri në 5 vjet.” Shtimi po ashtu nenin 181 Kodi penal i RSFI-se (Shkelje e ligjit nga gjyqtari).

tenton te përfilloj dobi materiale apo te shkaktoj dëme duhet te argumentohen. Është e nevojshme te vërtetohet se kryerësi veprës kishte qellim te përfitimt te dobisë materiale për personin tjetër apo te shkaktoj dëme tek personi tjetër. Ne vazhdim ” vepra penale është e kompletuar kur një dokument ilegal nxirret apo ligji është shkelur ne ndonjë mënyre tjetër. Ne këtë mënyre nuk është e nevojshme te përfilloj dobi materiale për apo te shkaktoj dëme personit tjetër, mirëpo për te ekzistuar një veprë penale është e nevojshme qe shkelja e ligjit eshët e kryer me një qellim te tille ne mendjen e tij. Nëse dobia materiale është fituar apo demi është shkaktuar vepra penale duhet ende te ekzistojë. Vepra penale mund te kryhet vetëm me paramendim. Si një akt i qëllimshëm për te fituar dobi materiale apo te shkaktoj dëme është parakusht për këtë veprë penale, vetëm paramendimi i menjëhershëm është i mundur.”

Ligji nen nenin 346 te KPK-se kërkon me tepër se demonstrim themelor te *mens rea* te të pandehurit . Duhet te argumentohet se ne kohen e veprë penale, i pandehuri ka tentuar te përfilloj dobi materiale te paligjshme për vete, personin tjetër apo te shkaktoj dëme tek tjetri si rezultat i veprimëve te tij/saj. Nëse përfitimi material ishte i suksesshëm dhe / apo demi është shkaktuar, qëllimi i veçantë i kryerësit për te cilën pragu është me i larte se qellim kryesor nen nenin 15 te KPK-se duhet te duket nga provat ne dispozicion. Gjykata konsideron se është argumentuar gjate gjyqimit se një nxjerrje e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore, dmth aktvendimi ne fazën e apelit, është lëshuar ne rastin e trashëgimisë nga Ekrem Agushi duke vepruar ne cilësinë e kryetarit te trupit gjyqës dhe gjyqtari raportues ne gjykatën e qarkut te Prishtinës me 4 Qershor 2008, ne kuptim me nenin 346 te KPK-se.

Prokurori ne aktakuzë nuk ka cekur palën e dëmtuar ne këtë rast. Akuza kunder te pandehurit nuk ka përmbajtur ndonjë informatë për persona te dëmtuara. Gjate seancës se konfirmimit te mbajtur ne gjykatën komunale te Prizrenit me 2 Mars 2010 kur gjyqtari i EULEX-it e ka hedhur poshtë aktakuzën prokurori ka pranuar se ai nuk e ka cekur palën e dëmtuar ne aktakuzë. Me tepër ai ne mënyre te qarte ka cekur se dëmtimi iu është shkaktuar Republikës se Kosoves⁴⁸. Sidoqoftë as qëllimi i Ekrem Agushit ne kohen e kryerjes te veprës e as ndonjë përfitim material apo dëmtim nuk është nxjerrur ne shesh gjate gjyqimit.

Te dy dëshmitar dëshmuuan se nuk kane ndonjë informate lidhur me raportin ndërmjet palëve ne kontestin civil dhe Ekrem Agushit. I pandehuri ka deklaruar te njëjtën. Gjykata gjene se provat te prezantuara gjate gjyqimit nuk janë vërtetuar ekzistimin e një raport te tille ndërmjet Ekrem Agushit dhe palëve ne procedure civile. Ne vazhdim prokuroria nuk ka prezantuar asnjë element i cili tenton te

⁴⁸ Shtimi procesverbalin e seancës se konfirmimit KA. nr. 116/09 e dates 2 Mars 2010, faqe 4 dhe 5

dëshmoj se Ekrem Agushi ka përfutur ndonjë dobi materiale nga nxjerja e vendimit të dyshuar (psh, favor/ premtim ndaj të pandehurit, transfer të të hollave etj...).

Asnjë nga dëshmitarët (me herët anëtar të tjerë të kolegjit) nuk kanë vrejtur ndonjë parregullsi apo ndonjë keq sjellje të bere nga i pandehuri gjate gjykimit të rasit civil.

Duhet të ceket se gjykata e qarkut të Prishtinës ne një kohe të caktuar ka pasur numër të madhe të rasteve ne pritje, mungese të gjyqtarëve, qe sqaron transferin e disa gjyqtarëve nga gjykata ekonomike e qarkut ne gjykatën e qarkut të Prishtinës, për te punuar ne raste civile. Bashkim Latifi deklaroi se raste të vjetra iu janë dhënë gjyqtarëve ne mënyrë proporcionale dhe se ata i kanë gjykuar për afërsisht 100 raste ne muaj.⁴⁹ Dëshmitari Sulejman Nuredini ka deklaruar se” një kolegj mundet ndonjëherë të raportoj disa raste, ne këtë rast gjate një muaji ne i kemi gjykuar 120 raste.”⁵⁰ Dëshmitari po ashtu deklaroi se ai është dashur të merret me një volum të madhe të punës dhe iu janë dashur qe të lexoj deri ne 40 raste. Të dy dëshmitar kanë vrejtur se kishite mjaftë presion ne gjykate për shkak të ngarkesës. I pandehuri po ashtu ka cekur këtë fakt dhe nuk është kundërshtuar nga kolegj i penal.

Ne mendimin e trupit gjykues, gabimet mund të ndodhin gjate gjykimit të rasteve, veçanërisht kur gjyqtari ka shume pune, dhe punon nen presion. Edhe Bashkim Latifi ka pranuar se kishte “raste kur kolegu ime ka nënshtruar disa nga aktvendimet e mija të cilat përmbanin gabime dhe ne me vone do të nxirrnim një aktvendim të korrigjuar. Ishin gabime teknike për shkak të volumit të madhe të punës.”⁵¹

Çfarëdo gabim i bere nga gjyqtari gjate ushtrimit të funksionit të tij/saj nuk na drejton me dashje ne inicimin e hetimeve penale nen nenin 346 të KPK-se. Një keq interpretim i tille apo aplikim i gabuar i dispozitave ligjore mund të rregullohen nga gjykata e shkalles se dyte gjate procedurës se apelimit.

Kjo është çka ka ndodhur ne këtë instance. Ne baze të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë gjykata Supreme e Kosoves anuloi aktvendimin e gjykatës se qarkut të Prishtinës të dates 4 Qershor 2008 dhe e ka kthyer rastin për rigjykim ne Shtator të vitit 2009⁵². Ne vazhdim procedura disiplinore mund të iniciohen për të vendosur

⁴⁹ Procesverbali i shqyrtimit kryesor, rasti P. nr. 91/7/10, me 6 Tetor 2010, dëshmia e Bashkim Latifi, fage 11

⁵⁰ Procesverbali i shqyrtimit kryesor, rasti P. nr. 91/7/10, me 6 Tetor 2010, dëshmia e Sulejman Nuredini, fage 5

⁵¹ Procesverbali i shqyrtimit kryesor, rasti P. nr. 91/7/10, me 6 Tetor 2010, dëshmia e Bashkim Latifi, fage 16; shih inter alia fagen 17

⁵² Prova B4, aktvendimi i gjykatës Supreme të Kosoves, MLC, nr. 12/2008 e dates 11 Shtator 2009, ne baze të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë; Prova B5, aktvendimi i gjykatës se Qarkut të Prishtinës Ac. nr. 1103/2009 i dates 8 Tetor 2009.

nreth qeshtjes se nxjerjes se kundërligjshme te vendimeve gjyqësore nga anëtar te KGJK-se, sikurse qe ishte ne rastin e te pandehurit.

Ne instance prezente, nuk është vërtetuar se Ekrem Agushi ka vepruar me qellim te përfitimt te kundërligjshëm te dobisë materiale për vete, personin tjetër apo ka shkaktuar dëme personit te trete, sikurse qe kërkohet ne nenin 346 te KPPK-se.

Duke marrur parasysh argumentet e lartcekura dhe përmbajtjen e nenit 396 (9) te KPPK-se gjykata është e obliguar qe te cek arsyet, neni 390 (3) te KPPK-se si arsye e drejtpërdrejte te lirimit. Nuk është dëshmuar se i akuzuari ka kryer aktin për te cilën është akuzuar.

Prandaj i pandehuri shpallet i pafajshëm

4. Këshillë Ligjore

Konform nenit 398 (1) dhe nenit 399 te KPPK-se, personat e autorizuar mund te parashtrrojnë ankesën kundër aktgjykimit te lëshuar ne gjykatën e shkalles se pare ne afate ligjor prej (15) ditësh nga dita kur kopja e aktgjykimit është shërbyer.

Witold Jakimko

Kryetari i trupit gjykues

Christin Nilsson
Procesmbajtësja

